

VENDIM
Nr.8, datë 12.3.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.2.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26/12 Akti që i përket:

KËRKUES: Gjergji Habilaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Administratorët e Shoqërisë “Vefa” sh.p.k., zyra e përmbarimit, TIRANË

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

VËREN:

Kërkuesi, me vendimin nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është shpallur kreditor të shoqëria “Vefa” sh.p.k. në administrim për shumën 42 830 484 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi pala e paditur nuk ka ushtruar ndaj tij rekurs brenda afatit 30-ditor.

Me vendimin nr.114, datë 10.11.2005, Gjykata e Apelit Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit të mësipërm dhe zyra e përmbarimit gjyqësor ka filluar procedurat e ekzekutimit të vendimit që në janar të vitit 2006.

Administratorët e Shoqërisë “Vefa” i janë drejtuar Gjykatës së Lartë duke kërkuar fillimisht rivendosjen në afat dhe më pas rishikimin e vendimit nr.94, datë 28.9.2005 të Gjykatës së Apelit. Këto kërkesa nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë.

Më pas, ata i janë drejtuar Gjykatës së Apelit me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. Kjo Gjykatë, me vendimin nr.37, datë 2.5.2006 ka rrëzuar padinë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr.16, datë 22.1.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit.

Vendimi gjyqësor i formës së prerë, edhe pas këtyre proceseve gjyqësore, nuk është ekzekutuar.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese më datë 9.5.2008, kërkuesi kërkon konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Në seancën plenare, më datë 24.2.2009 kërkuesi hoqi dorë nga kërkesa e tij, duke u shprehur se gjykimi i mëtejshëm i çështjes nuk paraqet interes për të. Heqjen dorë nga kërkesa kërkuesi e ka depozituar edhe me shkrim pranë Gjykatës më datë 26.1.2009.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.” Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese iu referua Kodit të Procedurës Civile (KPC), neni 299/b, i cili parashikon se “gjykata vendos pushimin e gjykimit nëse paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë” .

Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenin 299 të KPC, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Kujtim Puto, Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi